

KËRKESË
Nr. 5616, datë 26.10.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga projekti "Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike, të qytetit të Vlorës".

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë për shpronësim, të cilët të jenë të pajisur me dokumente pronësie, të lëshuar nga ZVRPP, Vlorë.

Vlera totale e shpronësimit është 1. 930.600 lekë (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind) lekë, respektivisht:

-Agush Avdullai, për sipërfaqen $4540 \text{ m}^2 \times 197 \text{ lekë} = 894.380 \text{ lekë}$

-Skënder Rrapi, për sipërfaqen $3500 \text{ m}^2 \times 197 \text{ lekë} = 689.500 \text{ lekë}$

-Lirim Hania, për sipërfaqen $1760 \text{ m}^2 \times 197 \text{ lekë} = 346.720 \text{ lekë}$

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni